REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 13/17
Datë/Datum 30.01.2017
PRISHTINË PRIŠTINA

Republika e Kosovës

Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

AKT PËRCJELLËS

Për:	Menaxherin e prokurimit: **Komuna Gjakovë**	Kopje:	Paneli Shqyrtues - **OSHP Nr.13/17**
Nga:	Basri Fazliu - Ekspert shqyrtues i prokurimit		
Lënda:	Ekspertiza për lëndën **"Shërbime të telefonisë mobile për Komunen e Gjakovës", me nr. prokurimi: 632/16/072/221.**		
Përgjigjeje në ankesë:	**Telekomi i Kosoves Sh.a - Prishtinë**		
Datë	**30.01.2017**		

Bazuar në nenin 113.1 të LPP-së ju njoftojmë me ekspertizën e lëndës lidhur me aktivitetin e prokurimit: **"Shërbime të telefonisë mobile për Komunen e Gjakovës", me nr. prokurimi: 632/16/072/221,** të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **Komuna Gjakovë,** dhe me përgjigjeje ndaj ankesës së operatorit ekonomik: **Telekomi i Kosovës Sh.a,** me nr.prot.13/17, e datës 16.01.2017

Konform nenit 113.1, Pjesa IX e LPP-së, Eksperti Shqyrtues i pavarur, ka shqyrtuar dhe analizuar procesin e prokurimit në fjalë, dhe ka konstatuar si më poshtë.

AK është i thirrur që pas marrjes së raportit të ekspertit shqyrtues lidhur më këtë procedurë të prokurimit përkatësisht pretendimeve të bëra në ankesë, të veprojnë sipas kërkesave të nenit 115 të LPP-së.

1x1 Panelit Shqyrtues të OSHP-së.
1x1 Autoriteti Kontraktues.
1x1 Operatorit ekonomik ankues.

RAPORTI MBI EKSPERTIZËN E EKSPERTIT SHQYRTUES:

		19.01.2017		20.01.2017		30.01.2017
Nënshkrimi i ekspertit		Data e pranimit të autorizimit		data e fillimit të ekspertizës		data e dorëzimit të raportit të ekspertizës

N. 99, LPP - Baza ligjore e shqyrtimit.

Me datë: 16.01.2017, Organi Shqyrtues i Prokurimit, ka pranuar ankesën me numër të protokollit 291/16, e parashtruar nga operatori ekonomik: "Telekomi i Kosovës" Sh.A-Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Shërbime të telefonisë mobile për Komunen e Gjakovës", me nr. prokurimi: 632/16/072/221, të iniciuar nga Autoriteti kontraktues (AK) – Komuna e Gjakoves.
Konform nenit 113.1, Pjesa IX e LPP-së, eksperti shqyrtues e ka shqyrtuar dhe analizuar procesin e prokurimit në fjalë si më poshtë:

N. 111,-*Operatori Ekonomik Ankues:* ***"Telekomi i Kosovës Sh.A".***

Pikat e Ankesës:

Neni 7, i LPP-së - Barazia ne Trajtim / Jo diskriminim.

Neni 9.4, i LPP-së - Përcaktimi i nevojave qe duhet te Përmbushën.

Neni 38.7, i LPP-së - Kontratat Kornize.

Neni 27, i LPP - Dosja e Tenderit.

Neni 28, i LPP-së – Specifikat teknike.

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Neni 7 –Barazia ne Trajtim / Jo diskriminim

Autoriteti kontraktues Komuna e Gjakovës, gjate përpilimit të dosjes tenderuese ka përcaktuar nevojat e veta duke zgjedhur një procedurë të prokurimit, ose duke vendosur një kërkesë ose kriter të përzgjedhjes ose specifikacion teknik që në ndonjë mënyrë ka për qëllim të favorizojë ose diskriminojë kundër njërit ose më shumë operatorëve ekonomik.

Shih Neni 7, paragrafi 4:

Pa e cenuar paragrafin e mësipërm, autoritetit kontraktues posaçërisht i ndalohet që të përcaktojë nevojat e veta që duhet të përmbushen, specifikojë lëndën që do të prokurohet, ndajë ose përmbledh sasitë ose artikujt e tjerë që duhet të prokurohen, duke zgjedhur një procedurë të prokurimit, ose duke vendosur një kërkesë ose kriter të përzgjedhjes ose specifikacion teknik që në ndonjë mënyrë ka për qëllim të favorizojë ose diskriminojë kundër njërit ose më shumë operatorëve ekonomik.

Neni 9.4 – Përcaktimi i nevojave qe duhet te Përmbushën

- Ligji për Prokurim Publik gjegjësisht neni 9 paragrafi 4, kërkon nga Autoritetet Kontraktuese që të veprojnë si në vijim: *"autoriteti kontraktues kur është autoritet publik, autoriteti i tillë publik duhet të marrë masa të arsyeshme për t'u siguruar se lëndët që i përmbushin këto nevoja nuk janë në dispozicion nga ndonjë autoritet tjetër publik"*. Pra neni i lartë cituar rregullon rastet kur Autoriteti Kontraktues (Autoriteti Publik) ka nevojë për sigurimin e shërbimeve operator i të cilave po ashtu është një autoritet publik, për me teper edhe interpretimi i KRPP-se thekson se nje autoritet kontraktues publ;ik nuk ka nevoje te procedoj ndonje procedure te prokurimit përderisa nje sherbim ofrohet nga nje autoritet tjeter kontraktues publik. Shih citatin e KRPP-se:

Citati:

36. Duke marr për bazë dilemat e shfaqura të Autoriteteve Kontraktuese dhe, kërkesat e shumta të tyre (drejtuar KRPP-ës) që të bëhet e qartë se si duhet të veprohet në rastet kur një Autoritet Kontraktues (Autoritet Publik) ka nevoj për sigurim të shërbimeve të cilat i posedon një Autoritet tjeter po ashtu publik?

Konform nenit 87, paragrafit 2, nënparagrafit 2.8 të Ligjit Nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, KRPP ofron interpretim ligjor si në vijim:

Sa i përket çështjes së parashtruar më lartë, Ligji për Prokurim Publik gjegjësisht neni 9 paragrafi 4, kërkon nga Autoritetet Kontraktuese që të veprojn si në vijim:

"Nëse autoriteti kontraktues është autoritet publik, autoriteti i tillë publik duhet të marrë masa të arsyeshme për t'u siguruar se lëndët që i përmbushin këto nevoja nuk janë në dispozicion nga ndonjë autoritet tjetër publik".

Pra neni i lartëcituar rregullon rastet kur Autoriteti Kontraktues (Autoriteti Publik) ka nevoj për sigurimin e shërbimeve operator i të cilave po ashtu është një autoritet publik.

LPP, nuk e sqaron me tej se si autoritet publike do te rregullojnë plotësimin e nevojave te tyre (ne mes vete) meqë kjo është qeshtje e autoriteteve publike dhe/ose rregullave tjera.

Mirëpo është mëse e qartë se këto raste kanë të bëjë me **përjashtimet nga zbatimi i legjislacionit që rregullon prokurimin publik** kur një formë e partneritetit publiko privat realizohet (një AK mund të

kërkojë ofrimin e një shërbimi në shërbimet e tijë ose shërbimeve te një autoriteti tjetër kontraktues pa inicuar ndonjë procedurë tenderimi, të ashtuquajtura përjashtim " në shtëpi).

Si përfundim pas analizimit të cekur më lartë (neni 9.4 të LPP-së) dhe të kërkesave tuaja, meqë nuk ka asnjë dispozitë tjetër të LPP-ës e cila i obligon Autoritetet Publike që të marrin masa për të mos lejuar "shtrembërimin e konkurrencës" (sikur ato nga direktiva e BE-es, neni 12.1) KRPP nuk ka se si të mos e trajtojë këtë çështje ashtu sikur është vendosur në nenin 9.4 te LPP-së

Neni 38, paragrafi 7 – Kontratat Kornize
Autoriteti kontraktues gjate aplikimit te procedurës se përzgjedhur te prokurimit (Procedure e hapur, kontrate kornize me nje OE), ka bere shkelje te nenit 38.7 ne momentin qe nuk ka përdorur dosjen standarde B28, te aprovuar nga KRPP, për këto lloj kontratash por ka përdor dosjen e tenderi për procedure te hapur B16. Andaj edhe kushtet e kontrates nuk perkojne me natyren e shërbime qe kërkohen me tender.

Neni 27 – Dosja e Tenderit
Gjithashtu , përgatitja e dosjes se tenderit nuk eshte ne përputhje me nenin 27 te LPP-se, pasi qe informatat e dhena ne dosje te tenderit jane ne kundërshtim me njoftimin e bere nga KRPP-ja, përderisa Komuna e Gjakovës nuk ka dhene sasite perkatese te shërbimeve, pozicioneve si dhe ajo qe eshte me shqetësuese ka kërkuar Pajisje telefonike pa përcaktuar sasine e cila mund te interpretohet si BONUS te cilat gjithashtu jane rreptesisht te ndaluara qe institucionet publike te pranojne dhurata ne forme te tille.

Neni 28 - Specifikimet teknike
Kërkesat ekzekutuese dhe funksionale duhet të jenë të sakta në mënyrë që të iu mundësoj tenderuesve që të përcaktojnë lëndën kryesore të kontratës dhe t'i lejoj autoritetet kontraktuese që të shpërblejnë kontratën. Standardet apo specifikimet e tjera të paragrafit 4. dhe 5. të këtij neni mund të përdoren si një mjet i ruajtjes së përputhshmërisë me kërkesat ekzekutuese apo funksionale.

Njoftim për të gjitha autoritetet kontraktuese

Njoftohen të gjitha autoritetet kontraktuese se KRPP është duke monitoruar ne vazhdimësi te gjitha llojet e Njoftimeve te përgatitura nga autoritetet kontraktuese. Gjate këtij procesi është konstatuar se një numër i konsiderueshëm i autoriteteve kontraktuese ende po përdorin (sidomos për kontrata kornize) kriterin e vlerësimit "Çmimi për njësi" pa specifikuar sasinë e përafërt dhe /ose pa përdorur peshimin e çmimit për "kategori te shërbimeve" ose secilit "artikull".
KRPP e konsideron se lidhja e kontratave me çmime për njësi *pa e caktuar sasinë në Njoftimin për Kontratë dhe në Dosjen e Tenderit dhe /ose pa aplikuar metodën e "peshimit" konsiderohet shkelje te dispozitave ligjore (nenit 38 paragrafi 2 dhe 52, paragrafi 6)* te Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092.
Kur kriter për dhënie të kontratës në Njoftimin për Kontratë dhe në Dosjen e Tenderit caktohet: *"tenderi i përgjegjshëm me çmimin më të ulët"* dhe në rastin e kontratave për shërbime të shumëfishta ose në rast të kontratave me çmime për njësi kur sasia është përcaktuar si sasi indikative, **çmimet mund të peshohen në bazë të rëndësisë së secilës** " kategori të shërbimeve" " ose secilit "artikull " në mënyrë që autoriteti kontraktues të përcaktojë **se cila është oferta me çmimin më të ulët**. *(shih paragrafin 6 të nenit 52 të këtij ligji).* Për këtë qellim, KRPP ka nxjerr dhe ju duhet te referoheni ne UA 03/2015 se bashku me shpjegimin "rast studimi" ne mënyrë qe te shmanget shkelja e dispozitave te cekura me lart dhe te lidhen kontrata jo ligjore.
KRPP, nuk do te publikoj asnjë lloj Njoftimi (Njoftimi për kontrate, Njoftimin për dhënie apo për nënshkrimin e kontratës) dhe do te deklaroj aktivitetet, vendimet dhe/ose kontratat jo ligjore ne rast se nuk janë respektuar dispozitat e cekura me larte apo cila do dispozite tjetër e legjislacionit për prokurim publik.

LINKU: https://krpp.rks-gov.net/Default.aspx?PID=NewsPub&LID=1&PCID=-1&CtlID=HTMLStatic&CID=PPRCNews&ID=313

PROPPOZIMI I TELEKOMIT TE KOSOVES

Te anulohet procesi i nisur nga Komuna e Gjakovës dhe te fillohet një procedure e re ne përputhje me interpretimin e KRPP_se dhe ne kërkesat e nenit 9.4 te LPP-se. Dmth Komuna e Gjakovës nuk ka nevoje te përdor procedure te prokurimit, pasi qe shërbimet ofrohen nga nje institucion publik qe përdor fonde publike.

Mënyra proceduese e anulimit është: Komuna e Gjakovës duhet te kërkoj nga KRPP ose autorizim që të bëjë anulimin e Njoftim Kontrate.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Demet materiale qe mund ti shkaktohen nga përdorimi i LPP-se nga ana e Komunës se Gjakovës, dhe janë shume te mëdha dhe ne vlere monetare ato mund te shkojnë me mijëra euro, përafërsisht **45.000,00** euro për 24 muaj.

Këto dëme ne mënyrë te drejtpërdrejtë dëmtojnë BUXHETIN e KOSOVES pasi qe TELEKOMI i KOSOVES është ndërmarrje publike dhe sic e ka përcaktuar KRPP konsiderohet **blerje ne SHTEPI**

10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

a) një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.
b) një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".
c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.
d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,
e) bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se,
f) Dëshminë e pagesës se tarifës se ankimit ne përputhje me nenin 118 te LPP-se, dhe
g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*

Procesi i prokurimit:

Data e njoftimit në KRPP-së për kontratë (N.35) :	15.11.2016
Lloji i procedurës së aplikuar (N.32-35):-	Procedur e hapur
Lloji i kontratës së publikuar(N.16):	Kontrat korniz me nje operator/Shërbime/vlerë e mesme
Afati i fundit për dorëzimin e ofertave (gjithsejtë ditë):	05.12.2016
Data e hapjes së ofertave (N.58):	13.12.2016
Data e njoftimit për dhënien e kontratës	29.12.2016
Kriter për dhënien e kontratës	Tenderi ekonomikisht më i favorshem.

Regjistri i ofertuesve sipas procesverbalit të hapjes publike (N.58):

Nr.	Tenderuesi	Vendi	LOT	Çmimi	Vëretje
1	"Telekomi i Kosovës"	Prishtinë		903.69€	JO
2	"Ipko"	Prishtinë		863.00 €	JO

Në këtë aktivitet të prokurimit kanë marrë pjesë dyë (2) operator ekonomik, në procesverbal të hapjes nuk është rexhistruar asnjë vërejtje në lidhje me hapjes e ofertave.

Kriteret për kualifikim:

III.2.1)Kërkesat e përshtatshmërisë:
- OperatoriEkonomikduhettipërmbushëkërkesat e specifikuaranënenin 65 tëLigjittëProkurimitPublik (LPP).
- Vërtetim nga Administrata Tatimore e Kosovës.
- Vërtetim nga Gjykata kompetente.

Dëshmia e kërkuar dokumentare:
- Një deklaratë nën betim e nënshkruar nga tenderuesi duke përdorur formularin në Aneksin 2.
- Një vërtetim i nënshkruar nga Administrata Tatimore e vendit të themelimit të Operatorit Ekonomik, se Operatori Ekonomik në fjalë nuk është me vonesë për pagimin e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit të vitit para dorëzimit të tenderit (vlen për OE fitues).
- Një dokument nga Gjykata kompetente ku dëshmon se Operatori Ekonomik nuk është i falimentuar ose likuiduar (Kërkohet origjinali ose kopja e vërtetuar, vlen për OE fitues).

III.2.2)Përshtatshmëria profesionale:
- Regjistrimisi Operator Ekonomiknëregjistrinprofesional, komercialdhe/aporegjistrin e ndërmarrjevenëvendin e juajtëthemelimit
- Certifikata e Numrit Fiskal
- Certifikata per Regjistrimnë TVSH e lëshuarnga ATK

- Licencanga ART

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

- Certifikata e regjistrimit të biznesit (kopje).
- Certifikata e numrit fiskal (kopje).
- Certifikata për regjistrim në TVSH (kopje).
- Licenca e lëshuarnga ART (kopje).

III.2.3) Kapaciteti ekonomik dhe financiar N/A

Dëshmia e kërkuar dokumentare:**N/A**

III.2.4)Kapaciteti teknik dhe profesional:

- Operatori Ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka së paku dy referenca të mira në 3(tre) vitet e fundit 2013,2014,2015

Dëshmia e kërkuardokumentare

- Listën nga Operatorit Ekonomik se ka referenca të mira nga ndonjë kompani apo organizatë (sektori publik apo privat).

Komisioni vlerësimit pran AK-së:

Përbërja dhe kualifikimi i komisionit vlerësues (N.80).

Lekë SINA: Kryesues,
Dardan KRYPA: Anëtar,
Dardan BAKIJA; Anëtar,

Komisioni vlerësues ka përfunduar punën (raportin e vlerësimit), me datë 29.12.2016.

Raporti i komisionit vlerësues:

Komisioni vlerësues pa mendime të ndara REKOMANDON për dhënien e kontratës ofertën e përgjëgjshme me çmim më të ulët që për këtë aktivitet të prokurimit të shpallet fitues Kompania IPKO, me seli në Prishtinë, me çmim total të kontrates 20,712.00€.

Përgjigjje në pretendimet ankimore nga Ekspertit shqyrtues: (N. 113.1), konform njoftimit të OSHP-së të datës 19.11.2014, nr.prot.848/14:

Në finalizim të analizimit dhe shqyrtimit të lëndës së tenderit për këtë aktivitet të prokurimit, bazuar në dokumentacionin që kanë pasur në dispozicion eksperti shqyrtues jep mendimin si në vijim:

Eksperti shqyrtues sqaron:

Autoriteti kontraktues gjatë zhvillimit të këtij aktiviteti të prokurimit ka zbatuar procedurë të hapur,

kontrat për shërbime, vlerë e mesme, kriter për dhënie të kontratës ka qenë: "Tenderi ekonomikisht më i favorshem". I pakënaqur me njoftimin për dhënie të kontratës të datës 29.12.2016, për këtë aktivitet të prokurimit, operatoret ekonomik ankues, "Telekomi i Kosovës sh.a", fillimisht kanë parashtruar ankesë në Autoritet kontraktues, dhe pastaj duke parashtruar ankesë edhe në OSHP me datë 16.01.2017, me pretendimet ankimore se janë shkelur neni: 7, neni 9 paragrafi 4, neni 38 paragrafi 7, neni 27 dhe 28 të LPP-së, (**pretendimi ankimor kryesor ka të bëjë me nenin 9.4 të LPP-së, prejashtimi i procedures së prokurimit kur shërbimi kryhet nga ndonjë autoritet publik), ku sipas nenit 9.4 të LPP-së, thuhet:** ***"Nëse autoriteti kontraktues është autoritet publik, autoriteti i tillë publik duhet të marrë masa të arsyeshme për t'u siguruar se lëndët që i përmbushin këto nevoja nuk janë në dispozicion nga ndonjë autoritet tjetër publik"***

Ne interpretim të asaj që u tha më lartë, si dhe në bazë të interpretimit të KRPP-së në lidhje me këtë çështje, po sqarojmë se i kemi shqyrtuar dhe analizuar shkresat e lëndes, konkretisht ato që lidhen me zbatim të vendimit të lartë përmendur, dhe atë si në vijim:

Pretendimi ankimor nr.1

Në lidhje me pretendimin ankimor sa i përket nenit 9, paragrafi 4, të LPP-së, konkretisht **prejashtimi i procedures së prokurimit kur shërbimi kryhet nga ndonjë autoritet publik,**

Eksperti shqyrtues vlerëson se qëndron pretendimi ankimor në lidhje me këtë, për faktin se në baze të nenit të lartë cekur (neni 9.4 i LPP-së), bazuar në interpretimin e KRPP-së për këtë qështje, në rastin konkret: Telekomi i Kosovës është autoritet publik sipas interpretimit të KRPP-së, duke i marrur për bazë dilemat e shumta të shfaqura nga Autoritetet kontraktuese në lidhje me këtë qështje, në bazë të interpretimit të KRPP-së Autoritetet kontraktues duhet të veprojmë në harmoni me nenin 9.4 të LPP-së, në lidhje me këtë qështje sa i përket shërbimeve telefonike si në rastin konkret.

Mendimi i Ekspertit Shqyrtues:

Eksperti shqyrtues duke u mbështetur në vlerësimet e lartë cekura, i rekomandon panelit shqyrtues që të APROVOJ si të BAZUARA ankesën OE "Telekomi i Kosoves", me seli në Prishtinë, për këtë aktivitet të prokurimit dhe njëherit të Anuloj vendimin "Njoftimi për dhënien e kontratës i datës 29.12.2016, "Shërbime të telefonisë mobile për Komunen e Gjakovës", me nr. prokurimi: 632/16/072/221", të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KK Gjakovë, dhe lënda të kthehet në ri-tenderim, nëse edhe më tutje ka interes Autoriteti kontraktues për këtë aktivitet të prokurimit.